



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE - DEGA E GJYKATËS FUSHË KOSOVE

Numri i lëndës: 2020:091669

Datë: 30.09.2023

Numri i dokumentit: 04739067

**P.nr.1422/20**

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NE PRISHTIË – DEGA FUSHË KOSOVË** - Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Penal, sipas Gjyqtares Laura Hoti Statovci, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Albrim Kastrati, në lëndën penale të akuzuarës K.K. nga F. K. për shkak të veprës penale “Vjedhje” nga neni 325 par. 1 të KPRK-së, e akuzuar, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm, PP/II.nr. 2235/2019 te datës 15.05.2019, jashtë seancës me datë 30.09.2023 përpiloi këtë:

**A K T G J Y K I M**

**E pandehura:**

K.K., e bija e H dhe A, e gjinisë M, e lindur me datë ..., ne M., me vendbanim në rr. "B" nr. ... KK P..., e martuar, amvisë, ka të kryer shkollën fillore, gjendjes së mesme ekonomike, me nr. personal ..., Shqiptare, Shtetas i Republikës së Kosovës.

Konform nenit 362 par 1 pika 1.3 të KPPRK-së,

**REFUZOHET AKTAKUZA**

**Sepse:**

Me datë 14.04.2019, rreth orës 14:40 në lokalin afarist "G. C." në rr. "N. T." F. K., e pandehura K.K.me qëllim të përfitimit të dobisë pasurore në mënyrë të kundërligjshme ka marrë: çantën, 50 (pesëdhjetë) euro, një parfum, çelësat e veturës, letërnjoftimi, patën shoferi pronë të dëmtuarës V. M., me ç rast të njëjtit i ka sjellë dëm material në vlerë të pa përcaktuar,-

- *Me këtë kishte për të kryer veprën penale Vjedhje nga neni 325 par. 1 të KPRK-së.*

**A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore në Prishtinë/Departamenti i Përgjithshëm, ka ngritur aktakuzë, PP/II.nr. 2235/2019 e datës 15.05.2019, kundër të akuzuarës K.K., për shkak të veprës penale “Vjedhje” nga neni 325 par. 1 të KPRK-së.

Aktakuza e njëjte e Prokurorisë Themelore në Prishtinë PP/II.nr. 2235/2019 e datës 15.05.2019 rezulton të jetë pranuar dhe regjistruar dy here përkatësisht njëra në Gjykatën Themelore në Prishtinë dhe tjetra në Gjykatën Themelore Prishtinë – Dega Fushë Kosovë andaj duke qenë se lënda në Gjykatën Themelore në Prishtinë është procedura respektivisht është zgjidhur pasi e pandehura ka pranuar fajësinë dhe me këtë rrethanë është njoftuar Gjykata Themelore Prishtinë - Dega Fushë Kosovë, Gjyqtarja e çështjes ka nxjerr aktgjykim refuzues pasi që ne baze të nenit 362 par 1 pika 1.3, të KPPRK-së, ekzistojnë rrethana që e përjashtojnë ndjekjen penale ashtu që e pandehura nuk mundet në mënyrë të përsëritshme për të njëjtën vepër penale të ndiqet apo dënohet dy herë, andaj lidhur me këtë gjykata ka vendosur si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

Nga arsyet e cekura më lartë dhe me zbatimin e nenit 362 par 1 pika 1.3 të KPPRK-së është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-DEGA FUSHË KOSOVË,**  
**DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM PENAL**  
P.nr.1422/20 më datë 30.09.2023

**Bashkëpunëtori Profesional**

**Gjyqtarja e vetme Gjykuese**

**Albrim Kastrati**

**Laura Hoti Statovci**

**KËSHILLA JURIDIKE:**

Kundër këtij aktgjykimi palët kanë te drejtë të parashtrojnë ankesë në afat prej 30 ditësh, nga dita e pranimit të të njëjtit. Ankesa i dërgohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë përmes kësaj Gjykate.